



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



**ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ)** sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 dhe në përputhje me nënparagrafin 1, paragrafi 6 i Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, me datën 10.07.2024, merr këtë:

**VENDIM**

**Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS**

- I. Subjektit politik LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS, i shqiptohet gjoba në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkeljen sipas nënparagrafit 1, paragrafi 6 i nenit 21 të LFSP.
- II. Subjekti politik LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj shumën e gjobës së shqiptuar sipas pikës I të këtij vendimi dhe të dorëzojë në Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- III. Nëse subjekti politik LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS, nuk paguan gjobën brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit të Zyrës, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politik në shumë e gjobës së shqiptuar.
- IV. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.

**Arsyetim**

Subjekti politike LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS, është subjekt politik i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës sipas rezultateve të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës të certifikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 950/2021 të datës 13 mars 2021. Ky subjekt politik përfiton mjete financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, në përputhje me nenin 9 të LFSP.

Sipas të gjeturave të prezantuara në raportin përfundimtar të auditimit për shpenzimet e bëra për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS ka prezantuar një shpenzim, i cili është në kundërshtim me nenin 8 të LFSP për qëllimet e përdorimit të Fondit për mbështetjen e subjekteve politike.

Subjekti politik, sipas faturës nr. 25, të datës 30.05.2023, ka realizuar pagesën në vlerën 2,000 euro, biznesit GEO AUTOCAD SH.P.K, për shërbimin “incizimi detajues i gjendjes faktike të rrugës Nysret Saharsoj, në lagjen Hoqa e Mahallës, në komunën e Prizrenit” për projektim të infrastrukturës rrugore.

Realizimi i pagesës për biznesin GEO AUTOCAD SH.P.K është bërë në tri (3) pjesë, përmes transaksionit bankar nga banka komerciale NLB Banka, siç vërtetohet në qarkullimin bankar të periudhës 01.01.2023 – 31.12.2023. Transferet janë realizuar në datën 15.06.2023 në vlerën 500 euro, në datën 21.07.2023 në vlerën 1,000 euro dhe në datën 30.10.2023 në vlerën 500 euro.

Subjekti politik LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë. Në rast të dështimit të pagesës së gjobës brenda afatit të dhënë si në pikën II të këtij vendimi, subjektit politik nuk i transferohen mjetet financiare nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politik në shumë e gjobës së shqiptuar.

**Nga sa u tha më lartë, Zyra vendos për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.**

**Prishtinë, 10.07.2024**

**Drejtori i Zyrës**



**Besnik Buzhala**



Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politik LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politike LËVIZJA PËRPARIMTARE E ROMËVE TË KOSOVËS.

**Këshilla juridike:** Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.